


**MINISTRIA FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANES KAPSHTICE**



LËNDA: Kërkesë për shpallje publike

DREJTUAR: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT / TIRANE

DREJTUAR: DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: Korçë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Korçë-Durrës, km 1,
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedures Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për vendimin per shpallje debitor, per ;

Subjekti: "NIKOLIN DIMA" me ID L00016612P

Vendimi : Nr 108 date 25/05/2026

Detyrimi: 35.875 leke detyrime, 20.000 leke penalitete si edhe kamate vonesat qe aplikohen mbi detyrimin.


Kerkesa paraqitet mbeshtetur ne faktin se subjekti nuk eshte njoftuar ne adresen e deklaruar ndaj, lutemi qe për vazhdimin e procedurave ligjore, me tej pasi per rikuperimin e borxhit doganor, është domosdoshmëri shpallja publike dhe data e shpalljes publike(bashkëlidhur vendimi Nr 2677 date 11/09/2025).

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

KRYETARI I DEGES SE DOGANES KAPSHTICE

DRITAN ÇEKANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS KAPSHTICË

VENDIM

Nr. 108 date 25.02 2026

Mbasi shqyrtova proces verbalin e konstatimit me Nr 536 prot, date 25/02/2026 te protokolluar ne Degën e Doganës Kapshtice, te Kontrollit Aposteriori te Deges Doganore Kapshtice për kontrollin e deklarates doganore import 4 R 1453 date 23/01/2026, IND- Zhdoganim i mallrave per individe date 23.01.2026 që i perket subjektit "NIKOLIN DIMA" me Nr. Identifikimi ID L00016612P, adresë Kostur, Greqi perfaqësues/deklarues agjensia doganore Best Choice/J100 Kapshticë.

KONSTATOVA SE:

Nga proces verbali me Nr 536 prot, date 25/02/2026 te protokolluar ne Degën e Doganës Kapshtice, te Kontrollit Aposteriori te Deges Doganore Kapshtice për kontrollin e deklarates doganore import 4 R 1453 date 23/01/2026, IND- Zhdoganim i mallrave per individe date 23.01.2026, që i perket subjektit "NIKOLIN DIMA" me Nr. Identifikimi ID L00016612P, adresë Kostur, Greqi perfaqësues/deklarues agjensia doganore Best Choice/J100 Kapshticë, rezulton se ne zbatim te nenit 49 te ligjit Nr.102/2014 date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise, VKM Nr.651 date 10.11.2017 "Per Dispozitat Zbatuese te Kodit Doganor", Udhezimit Nr.3 date 23.01.2018 "Per vleresimin e mallrave per qellime doganore", eshte kryer kontrolli i deklarates doganore Im4, R1453/IND- Zhdoganim i mallrave per individe- date 23.01.2026 që i perket subjektit "NIKOLIN DHIMA" me Nr. identifikimi ID L00016612P, adresë Kostur, Greqi perfaqësues/deklarues agjensia doganore Best Choice/J100 Kapshticë, ku rezulton se subjekti ka deklaruar per qarkullim te lire artikujt:

Elektromotore te ndryshem (te perdorur), kodi tarifar *85013200*, Tavolina metalike (te perdorura), kodi tarifar *94032080*, Rafte metalike (te perdorura), kodi tarifar *94031091*, Diferencial makine (i perdorur), kodi tarifar *87089997*, vendi dërgues eksportues Greqi, kutia 37 e DAV-it –Regjimi-4000/IND.

Evidentohet gjithashtu ne proces verbal se ne momentin e depozitimit te deklarates doganore Im4, R1453 date 23.01.2026, sistemi ne menyre automatike ka bere perzgjedhjen e saj ne kanal te verdhe dhe se gjate perpunimit te deklarates nga sektori SVQ ne DPD eshte pranuar vlere e transaksionit.

Evidentohet se nga analiza e indikatoreve te shqyrtimit te vleres doganore mbeshtetur ne Udhezimin Nr.03 date 23.01.2018, te Ministrit te Financave dhe Ekonomise "Per vleresimin e mallrave per qellime doganore" per artikujt e deklaruar Elektromotore te ndryshem (te perdorur), kodi tarifar *85013200*- Tavolina metalike (te perdorura), kodi tarifar *94032080*, - Rafte metalike (te perdorura), kodi tarifar *94031091* dhe Diferencial makine (i perdorur), kodi tarifar *87089997* ekziston nje ndryshim i dukshem midis çmimeve te deklaruar dhe çmimit ne te dhenat e disponueshme si dhe çmimeve te aplikuar dhe te pranuar nga deklaruesi per mallrat identike dhe te ngjashme per te njejtet artikuj e njejta origjine.

Evidentohet se vlere doganore e mallrave nuk mund te percaktohet ne baze te nenit 66 te Ligjit Nr.102/2014 date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise" duke u bazuar vetem ne çmimin e blerjes pa marre dokumenta shtese ne mbeshtetje te transaksionit si kontrate me firmen eksportuese, fatura e pagesave per transport dhe siguracion malli, dokumenta justifikuese te kushteve te levrimit te mallit, dokument transporti, dokumenta bankare qe vertetojne transferimin faktik te shumave monetare ne lidhje me transaksionin e kryer etj.

Ne vijim te parimeve te rivleresimit doganor te mallrave se kur pas dyshimeve te lindura nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqerues dhe pas sqarimeve dhe informacioneve shtese te vena ne dispozicion nga importuesi nuk justifikohet plotesisht vlera e transaksionit atehere per vleresimin e mallrave ne fjale perdoren sipas radhes metodat e vleresimit duke ndalur ne metoden me te pare per te cilen ka te dhena te mjaftueshme. Bazuar ne Udhezimin Nr.3 date 23.01.2018 "Per vleresimin e mallrave per qellime doganore -ndryshuar me Udhezimin Nr.26 date 17.12.2025 pika 10/h rezulton se: "Kur importohen mallrat e perdorura dhe transaksioni i paraqitur nuk justifikon gjendjen e tyre nga Dega Doganore apo strukturat e posaçme ngrihet grup vleresimi qe merr ne konsiderate sipas rastit vitin e prodhimit ,shkallen e amortizimit,gjendjen reale te tyre por jo me pak se 40 % te vleres te mallit te ri. "

Vlera doganore do te percaktohet ne baze te te dhenave te disponueshme ne territorin doganor te Republikes se Shqiperise si dhe vlerave doganore percaktuar me pare, per keta artikuj duke marre ne konsiderate dhe bazen ligjore te mesiperme çmimi i aplikuar llogaritet si me poshte dhe referuar process verbalit i cili behet pjese integrale e vendimit administrativ:

- a) Elektromotore te ndryshem (te perdorur) çmimi i aplikuar:
 - 1 cop,75 kw – Vleresim bazuar ne vleren e mallrave te ngjashme konkretisht R20256 Kapshtice vlera 373.27 euro/copa (746.55 euro x 50 % i perdorur).
 - 8 cope, 1.1 Kw deri 4 kw – Vleresim bazuar ne vleren e mallrave te ngjashme ,konkretisht R21154 Kapshtice çmimi 119.22 euro/copa (238.44 euro/copa x 50 % i perdorur).Vlera 8 cop x 119.22 € = 953.76 euro. Vlera totale= 373.27 € + 953.76 € = 1,327.03 euro.
- b) Tavolina metalike (te perdorura),
 - Vleresim bazuar ne te dhenat e disponueshme shkresa Nr.779 Prot date 16.01.2013 çmimi = 90 lek/kg/cif (180 lek/kg/cif x 50 %). Vlera 350 kg x 90 lek/kg= 31,500 lek.
- c) Rafte metalike (te perdorura).
 - Vleresim vlera e mallrave te ngjashme çmimi = 0.7 euro/kg/fob.Vlera=49 euro
- d) Diferencial makine (i perdorur),
 - Vleresim vlera e mallrave te ngjashme çmimi = 1.8 euro/kg/fob.
 - Vlera 80 kg x 1.8 €/kg= 144 euro.

Bazuar ne nenin 66 -70 te ligjit Nr.102/2014 date 31.07.14 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise" subjektit "Nikolin Dhima" me NIPT L00016612P, adresë Kostur,Greqi perfaqësues/deklarues agjencia doganore Best Choice/J100 Kapshticë, per deklaraten doganore Im4, R1453 date 23.01.2026 i linden detyrime doganore shtese ne shumen 35,875 leke.

II)Importi i mallrave tregetare pa NIPT, referuar dispozitave te ligjit doganor dhe fiskal ne Republiken e Shqiperise", importi i mallrave ndahet ne dy kategori kryesore: Import personal, ku individet pa NIPT (Numer Identifikimi per Personin e Tatueshem) ku mund te importojne mallra vetem per perdorim personal jo per qellime tregetare.Mallrat i neneshtrohen kontrollit doganor ne varesi te natyres dhe vleres se tyre dhe 2) Import tregetar, ku perfshihen importi i mallrave me natyre tregetare kerkon paisjen me NIPT. Te gjithë personat fizike dhe juridike te perfshira ne aktivitetin e importit dhe eksportit jane te detyruara te rregjistrohen,te paisen me NIPT-Numrin e Identifikimit te Personit te Tatueshem-ne menyre qe te paguajne Tvsh-ne dhe se cdo person qe do te kryejë nje veprimtari ekonomike tregetare eshte i detyruar te beje regjistrimin fillestar te tij ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB) sipas procedurave te percaktuara ne ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" i ndryshuar. Njekohesisht egziston detyrimi per bizneset qe te jene te rregjistruara ne sistemin doganor Asycuda World i cili perdoret nga Dogana Shqiptare per perpunimin e deklaratave dhe pagesen e detyrimeve. Pa NIPT nje individ nuk mund te kryejë import me natyre tregetare.

Nga verifikimi i deklarates doganore Im4, R1453 /IND- Zhdoganim i mallrave per individe date 23.01.2026 rezulton se subjekti ka deklaruar 9 (nente) elektromotore te perdorur per tu çmontuar, 7 (shtate) tavolina (bango) metalike te perdorura, 3 (tre) cope rafte metalike te perdorura dhe 1 (nje) diferencial makine i perdorur te cilat nga struktura verifikuese e Deges Doganes Kapshtice vleresohet se jane mallra jo per perdorim personal por import tregetar dhe importi i tyre kerkon regjistrim si subjekt tregetar me NIPT, pasi sasia e konsiderueshme dhe natyra e mallrave te importuara tregon qellimin tregetar te tyre. Per perdorim personal numri duhet te jete me i vogel dhe i justifikueshem.

Struktura verifikuese e Deges Doganes Kapshtice ka vleresuar me aktin e paraqitur se nga verifikimi i dokumentave bashkelidhur deklarates doganore, natyres se mallrave, sasise se konsiderueshme dhe qellimit te perdorimit te tyre konstatohet se mallrat jane me natyre tregetare dhe nuk justifikohen si per perdorim personal dhe se subjekti/shtetasi "Nikolin Dhima" me Nr. Identifikimi ID L00016612P, adresë Kostur, Greqi perfaqësues/deklarues agjensia doganore Best Choice/J100 Kapshticë ka kryer veprime doganore-vendosjen e mallrave te natyres tregetare ne qarkullim te lire pa qene i paisur me NIPT dhe mallrat konsiderohen se kane natyre tregetare dhe deklarimi pa NIPT konsiderohet deklarim i gabuar dhe/ose deklarim i pasakte (importi i parregullt).

Struktura verifikuese vlereson se ne referim te ligjit Nr.102/2014 date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republiken se Shqiperise" nenit 23 - Dhenia e informacionit autoriteteve doganore pika 2, a rezulton se: *"Depozitimi i nje deklarate doganore ,i nje deklarate te magazinimit te perkoheshem, i nje deklarate permbledhese te hyrjes, deklarates permbledhese te daljes, deklarate rieksperti ose njoftim rieksperti nga nje person drejt autoriteteve doganore ose dorezimi i nje aplikimi per nje autorizim apo çdo vendim tjeter e ben kete person pergjegjes per saktesine dhe teresine e informacionit te dhene ne deklarate, ne njoftim ose aplikim.*

Referuar nenit 149 - te ligjit Nr.102/2014 date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise rezulton se *"Deklarata doganore standarte duhet te permbaje te gjitha te dhenat e nevojshme per zbatimin e dispozitave qe rregullojne regjimin doganor ne te cilin mallrat jane deklaruar"*. Referuar Nenit 150/1 te ligjit Nr.102/2014 date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise – *"Dokumentat shoqeruese te kerkuara per zbatimin e dispozitave qe rregullojne regjimin doganor per te cilin jane deklaruar mallrat duhet te posedohen nga deklaruesi dhe tu vihen ne dispozicion autoriteteve doganore"*. Referuar nenit 250/a, 251/1.a te ligjit Nr.102/2014 date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise" ku parashikohet se *"mosrespektimi nga personi qe depoziton deklaraten doganore i detyrimit per te siguruar saktesine dhe plotesimin e informacioneve te dhena ne deklarate, njoftim apo aplikim, ne perputhje me shkronjen "a" te pikes 2 te nenit 23 perben kundervajtje administrative dhe denohet si e tille"*. Eshte vleresuar nga aktet se deklarimi per qarkullim te lire me deklarate doganore Im4, R1453 /IND- zhdoganim i mallrave per individe date 23.01.2026 e cila nuk permban dokumentat e nevojshme (NIPT) per zbatimin e dispozitave qe rregullojne regjimin doganor, ne te cilin mallrat jane deklaruar, perben kundervajte administrative dhe ndeshkohet si e tille. Ne baze te nenit 23,49, 72, 79, 250.1/a, 251 deri 254 dhe 259/1/b te ligjit Nr.102/2014 date 31.07.2014 Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise, per subjektin "Nikolin Dhima" me Nr. Identifikimi ID L00016612P (perfaqësues/deklarues agjensia doganore Best Choice/J100 Kapshticë) per llogari te te cilit eshte bere deklarimi doganor ka propozuar aplikim penaliteti ne masen 20,000 lek, ndaj ne mbeshtetje te sispozitave te cituara me siper

VENDOSA

1) Subjekti/Shtetasi/IND "NIKOLIN DIMA" me Nr. Identifikimi ID **L00016612P**, adresë Kostur, Greqi perfaqësues/deklarues agjensia doganore **Best Choice/J100** Kapshticë, te paguaje detyrimin doganor ne masen **35.875**(tridhjetë e pese mije e teteqind e shtatedhjetë e pese) lekë

2) Urdherohet kryerja e nderhyrjes ne deklaraten doganore **4 R 1453 date 23/01/2026, IND-** që i perket subjektit /shtetasit IND, "**NIKOLIN DIMA**" me Nr. Identifikimi ID **L00016612P** nga Kontrolli Aposteriori i Deges Doganore Kapshtice me qellim plotesimin e disponimit te mesiperm te pikes 1) te vendimit administrativ.

3) Subjektit/shtatesi/IND "**NIKOLIN DIMA**" me Nr. Identifikimi ID **L00016612P**, adresë Kostur, Greqi dhe/ ose perfaqësuesi/deklaruesi agjensia doganore **Best Choice/J100** Kapshticë, te ndeshkohen bashkerisht dhe solidarisht me penalitet, në vlerë **20.000**(njetzet mije) lekë.

3) Kunder ketij vendimi mund te ushtrohet ankim para Drejtorit te Pergjithshem te Doganave, ne afatin 30 ditor nga marja dijeni per vendimin, duke plotesuar kushtin e pageses se detyrimit te vendosur me kete vendim dhe garantim te penalitetit te aplikuar, ne perputhje me parashikimet e nenit 281 e vijues te ligjit 102/20014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise".

KRYETARI I DEGES SE DOGANES /KAPSHTICE
DRITAN ÇEKANI

